



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Fierzë, më 18. 12. 2024

PROCESVERBAL I DËGJESËS PUBLIKE

”Mbi Draftin e Planit të Mbarështrimit të Pyjeve dhe Kullotave Iballe-Mzi”.

I mbajtur sot, më 18. 12. 2024.

Vendi: **Në ambientet e Njesisë Administrative Iballe**

Ora: **10:00**

TEMA: DËGJESË PUBLIKE ”Mbi Draftin e Planit të Mbarështrimit të Pyjeve dhe Kullotave Iballe-Mzi”.

Në takim marrin pjesë:

Z. Ardmir Doda, Drejtor në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave;

Z. Pashuk Lulashi, Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit në Terren;

Z. Aleks Ndreka, Përgjegjës i IVMPK;

Z. Akil Zmalaj, Administrator i Njesisë Administrative Iballe;

Znj. Naze Selimaj, Sekretar i Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz.

Të pranishëm nga publiku në këtë konsultë janë **banorët e Njesisë Administrative Iballe si dhe Kryetarë të fshatrave.**

Znj. Naze Selimaj, Sekretar i Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz, përshëndet dhe falenderon të pranishmit në takim si dhe bën prezantimin e ekipit të bashkisë dhe të temës së diskutimit të dëgjesës publike për “Draftin e Planit të Mbarështrimit për Ekonominë Pyjore Iballe-Mezi”.

Fjalën hapëse e mbajti Administratori i Njesisë Administrative Iballe, **z. Akil Zmalaj**:



Ju falenderoj të gjithëve për pjesëmarrjen dhe në veçanti z. Ardmir Doda, Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, për dëgjuesën publike të organizuar, lidhur me mbarështrimin e pyjeve dhe kullotave në zonën tonë.

Ai thotë se kjo dëgjuesë është shumë të rëndësishme në mbështetje të nevojave për mbarështrim që kanë pyjet dhe kullotat në gjithë territorin e Njesisë Administrative Iballe.

Ky takim realizohet në kuadrin e Planit të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave dhe unë gjej rastin të kërkoj vigjilencë të shtuar nga ana e banorëve për t'i mbrojtur pyjet dhe kullotat që Zoti na ka dhuruar të mos digjen dhe të mos shkatërrohen. Pyjet tona janë pasuria më e madhe që ka rrethi i Pukës.

Ne si komunitet mirëpresim hartimin e planit Iballe-Mezi, është e qartë se ky plan evidenton nevojat për ndërhyrje në pyje me investime dhe procesi i digjitalizimit do t'i shërbejë të gjithë Njesisë Administrative Iballe për menaxhimin e mirë të pyjeve dhe kullotave për 10 vitet e ardhshme.

Në vazhdim fjalën e merr **z. Ardmir Doda**, Drejtor në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave:

Faleminderit dhe mirë se keni ardhë në këtë dëgjuesë konsultative ku pjesëmarrja tregon se interesi juaj dhe padyshim besimi ndaj sektorëve të pushtetit vendor po vjen duke u rritur. Jemi këtu për të dëgjuar zërin tuaj me vëmendje dhe për të marrë

mendimet dhe rekomandimet tuaja lidhur me mbarështrimin e pyjeve dhe kullotave në Njësinë tuaj Administrative, kështu që plotësojmë planin e mbarështrimit të pyjeve dhe kullotave për këtë zonë.



Z. Ardmir Doda shpjegon Draftin e Planit të Mbarështrimit për Ekonominë Iballe-Mezi. Ai thotë se ky Plan është hartuar nga një ekip profesorësh nga Fakulteti i Shkencave Pyjore (UBT) në bashkëpunim me stafin e Drejtorisë së Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave pranë Bashkisë Fushë-Arrëz.

Bashkia Fushë-Arrëz ka 45691 ha pyje dhe kullota që menaxhohen nga Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave që ndahen në disa sektorë dhe 3600 ha që janë në administrimin e administratës së zonave të mbrojtura të Shkodrës që është parku natyror i Munellës i shpallur me 26.01.2022.

Ne si Drejtori në administrimin tonë kemi 19 Njësi Ekonomike që ndahen në Ekonomi Pyjore.

Plani i Mbarështrimit për Ekonominë Iballe-Mezi është hartuar në vitin 1988 dhe nuk ka pasur asnjë arzhonim që atëhere duke sjellë vështirësi në menaxhimin e pyjeve dhe kullotave brenda këtij territori. Plani i ri sjell digjitalizimin e të gjithë territorit të Ekonomisë pyjore Iballe-Mezi duke bërë të mundur aksesin më të lehtë në menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve pyjore dhe kullosore.

Gjithashtu ky plan mbarështrimi sjell edhe mundësi të reja investimi në pyllëzim, përmirësim pyjore, sistemime malore, luftim proçesionalësh etj. për 10 vitet e ardhshme. Pas miratimit të tij drejtoria e pyjeve ka një plan mbarështrimi shumë të mirë për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave për ekonominë pyjore Iballe-Mezi dhe një pasqyrim të qartë në përputhje me ligjin e pyjeve dhe strategjinë kombëtare të pyjeve.

Z. Pashuk Lulashi, Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit në Terren, shpjegon për punën që është bërë në terren dhe në zyrë për marrjen e gjithë informacioneve për përpunimin e tyre për të sjellë planin e mbarështrimit për ekonominë pyjore Iballe-Mezi në përputhje të plotë me realitetin në terren sipas manualit për hartimin e planeve të mbarështrimit.

Z. Sokol Sokoli, Kryetar i fshatit Lëvoshë, përshëndet hartimin e planit të mbarështrimit për ekonominë pyjore Iballe-Mezi dhe bën thirrje për sa më shumë fonde për pyjet dhe kullotat për ti rigjeneruar ato dhe për ti mbrojtur.

Në emër edhe të banorëve të tjerë kërkojmë sistemimin e pyjeve dhe kullotave të zonës tonë, duke filluar nga pastrimi i bimëve të reja dhe duke pasë parasysh terrenin e thyer malor kërkojmë të bëhen prita malore.

Ky prezantim është i qartë dhe i shërben të gjithë komunitetit dhe mjedisit dhe ne jemi shumë dakord, mundësisht të hartohen të gjithë të tjerët.

Dod Zmajli, Kryetar i fshatit Berishë e Epërme:

Kemi nevojë për shumë vëmendje për pyjet për ti mbrojtur, sistemuar dhe për t'i shtuar ato përmes pyllëzimeve. Ai tha se ky plan 10-vjeçar i shërben të gjithë komunitetit pasi tregon realitetin dhe jep masa për zhvillimin e pyjeve.

Znj. Tereze Dema, Përshëndet hartimin e planit të mbarështrimit Iballe-Mezi nga ekipi i profesorëve të univeristetit dhe stafi i bashkisë. Ajo thotë që unë kërkoj të jemi unison ne si banorë dhe ata që japin pyjet në shfrytëzim dhe të jemi vigjilent në mbrojtje të pyjeve dhe kullotave. Pyjet dhe kullotat e zonës tonë kanë nevojë për investime, sisteme, mirëmbajtje, pastrime dhe luftim ndaj proçesionares.

Sa shpjegoi Drejtori, z. Ardmir kuptohet që ky plan do jetë i disponueshëm dhe i aksesueshëm nga banorët për mbrojtjen, ruajtjen dhe shtimin e fondit pyjor dhe kjo është në interesin tonë.

Z.Ditmir Përshpali:

Unë kërkoj të bëhen ripyllëzime;

Të pastrohen pyjet dhe kullotat e zonës tonë;

Të bëhen prita malore;

Gjithashtu ju bëj thirrje banorëve të shtojmë vigjilencën për mbrojtjen nga zjarri të pyjeve në zonën tonë



Këtu mbyllet takimi me banorët e Njesisë Administrative Iballe duke marrë falenderime dhe përshëndetje nga pjesëmarrësit.

SEKRETAR
Naze SELIMAJ

[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA FUSHË-ARRËZ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI I BASHKISË

LISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE NË DËGJESË PUBLIKE ME TEMË:
"DRAFTI I PLANIT TË MBARËSHTRIMIT TË EKONOMISË PAJORE IBALLE-MEZI"

DATA: 18 / 12 / 2024



Nr.	Emër	Mbiemër	Njësia/Qyteti/Fshati	Pozicioni/Profesioni	Firma
1.	ALTIN	ZMAICI	IBALLE		
2.	DOD	ZMAILI	IBALLE	PKTORE	
3.	Grim	Hajdari	IBalle	mirëmajtes	
4.	Grim	Shilli	IBalle	mirëmajtes	
5.	XHEI/AHR	ALIA	IBALLE		
6.	Basem	Ago	IBalle	mirëmajtes	
7.	PASHUR	CAKANI	F. ARREZ	D. SH. P	
8.	Aleks	Ndreka	F. ARREZ	D. SH. P	
9.	ARMIR	DODA	F. A	DREJTOR - DAPK	
10.	Kruston	Pemoti	IBalle	Kryeplok	
11.	Isuf	Isroji	IBalle		
12.	Astrit	Ngjue	IBalle	D. P. Gjyresh	
13.	Armond	Holaj	IBalle	Rajtor Gjyresh	
14.	Povlin	Gjetro	IBalle		



16.	Mare ^a	klase	Kryeti për	
17.	Kristjan Sokol	Iballe	Bonore	
18.	Ded Froni	Shopet	K. FSHATI	
19.	Tereze Demq	Iballe	mesues	Femur
20.	Flutura Aga	Iballe	senatore	T. H.
21.	Arvoliana Mika	Iballe	somitare	
22.	Agrin Cone	Iballe	Punonjes komune	
23.	Vitor Mirokaj	Iballe	P. Policie	
24.	Tom Gon	Iballe	Drejt. shkollë	
25.	Naze Selimaj	Fushë - AMEZ	Sekretar i KB Fushë - AMEZ	
26.				
27.				
28.				
29.				
30.				